

# Kenı nevojë për sigurime shëndetësore?

Në rast se banoni në Masaçusets, ka edhe programe të tjera të sigurimit shëndetësor dhe ne mund t'ju ndihmojmë. Na kontaktoni sot për të parë se si bëhet kërkesa.

Ne mund t'ju ndihmojmë.  
Vetëm kërkonı.



**MHA** MASSACHUSETTS HOSPITAL ASSOCIATION



*Fondet për këtë broshurë u dhanë nga Massachusetts Executive Office of Health and Human Services (Zyra ekzekutive e Masaçusetsit për shërbimet shëndetësore dhe njerëzore) - 2007*

**Në Masaçusets ka një ligj të ri sipas të cilit të rriturit moshës 18 vjeç e sipër duhet të kenë sigurim shëndetësor.**

Masaçusetsi ofron disa programe të sigurimit shëndetësor me kosto të ulët për të rriturit dhe fëmijët që jetojnë këtu. Përveç kësaj, ka edhe disa mundësi të tjera të reja. Kërkesa bëhet shumë thjesht dhe stafi ynë do t'ju ndihmojë duke ju shpjeguar përzgjedhjet që mund të vihen në dispozicionin tuaj.



### **Sigurimi shëndetësor mbulon koston e:**

- Vizitave te doktori
- Shtrimeve në spital
- Trajtimeve për shëndetin mendor dhe për abuzimin me alkool e drogë
- Ilaçeve me recetë
- Shërbimit të urgjencës

### **Sa më duhet të paguaj?**

Kjo varet nga të ardhurat vjetore të familjes tuaj. Disa sigurime shëndetësore kërkojnë bashkëpagesa të vogla (të hollat që paguani sa herë që përdorni shërbimet shëndetësore). Disa sigurime shëndetësore kanë një pagesë mujore (të hollat që paguani çdo muaj) si dhe bashkëpagesa.

### **Çfarë më duhet të sjell kur bëj kërkesën?**

- Vërtetim të të ardhurave vjetore të familjes (vërtetim të rrogës, sigurimeve shoqërore, letër nga punëdhënësi, pagesat e taksave ose deklarata nga banka)
- Vërtetim të nënshtetësisë dhe identitetit në qoftë se jeni qytetar amerikan (dokument identifikimi me fotografi dhe certifikatën e lindjes ose pasaportën)
- Ata që nuk janë nënshtetas duhet të sjellin vërtetim të statusit të imigracionit, në rast se kanë ndonjë të tillë